

Sapuni i pregatitur hand made është më i kërkuar në ditët e sotme se sa sapunët komercialë. Ky lloj sapuni mund të ishte ide për një dhuratë të përkryer, por gjithashtu edhe një hobi për disa. Në këtë Master Klasë Lady Albania do tju tregojë se si mund të pregatisni vet një sapun të tillë, sipas shijeve dhe fantazisë tuaj!

### **Përbërësit (për një sapun):**

- Bazë sapuni - 60-80 gr
- Vajë bajame - 1/2 lugë gjelle
- Vajë esencial lavande - 1-2 pika
- Ngjyryes me nuancë vjollce me pika
- Fletë të thata lavande
- Formëz



### **Si zjen sapuni:**



1. bazën e sapunit priteni në copa dhe hidheni në një enë me ujë dhe zijeni atë duke e trazuar vazhdimisht.



**2.** Kur baza e sapunit të jetë shkrirë plotësisht, zjarrin uleni në minimum dhe shtoni vajin e bajames.



**3.** Më pas shtoni ngjyruetin, sipas nuancave që preferoni dhe në varësi të fortësisë së ngjyrës që doni të përfitoni. Nëse shikoni se ngjyra nuk është arritur, shtoni edhe disa pika të tjera.



**4.** Fikeni zjarrin dhe shtoni përzierjen e vajit esencial të lavandës.



**5.** Në një formëz ku do të thahet sapuni, hidhni në fund disa gjethe lavande dhe pastaj mbi të hidhni masën e përgatitur të sapunit.



6. Lereni sapunin të thahet plotësisht e në fund hiqeni nga forma.

*Ju mund të realizoni sapunë me forma dhe ngjyra nga më të ndryshmet:*



**Krijim të mbarë!**